



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship
and Trade



API Agjencia për Pronësi Industriale
Agencija za Industrijsku Svojину
Industrial Property Agency

PËRDITËSIMI I PLANI TË INTEGRITETIT 2026

15/12/2025

Adresa: Rruga "Arbënor e Astrit Dehari" nr. 21, 10000 Prishtinë/Republika e Kosovës
Tel: +381 38 200 36 554
Web: www.kipa.rks-gov.net

1. Të dhënat e njësisë raportuese

Agjencia e Pronësisë Industriale në vijim (API) është agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe është përgjegjëse për mbrojtjen ligjore të shpikjes, markës tregtare, dizajnit industrial, treguesit gjeografik dhe emërtimet e orgjinës, topografisë e gjysmëpërçuesve, si dhe çështjet e tjera që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare nënshkruese e të cilave është Republika e Kosovës.

Agjencia është përgjegjëse për :

- Zhvillimin e procedurave për lëshimin e patentave, certifikatave të mbrojtjes shtesë për shpikje, regjistrimin e markave tregtare, dizajneve industriale, topografive të qarqeve të integruara, përcaktimeve të origjinës dhe treguesve gjeografik;
- Krijimin dhe mbajtjen e shënimeve të përcaktuara me këtë ligj;
- Propozimin, hartimin dhe publikimin e Buletinit Zyrtar të API-së, që përmban informacione në lidhje me aplikimin dhe të drejtat e regjistruara të objekteve të pronësisë industriale;
- Zhvillimin dhe promovimin e mbrojtjes së pronësisë industriale;
- Ofrimin e shërbimeve informuese për fushën e pronësisë industriale;
- Organizimin e testimit të përfaqësuesve të autorizuar në fushën e të drejtave të pronësisë industriale;
- Inicimin e propozimeve për nxerrjen e akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e pronësisë industriale;
- Bashkëpunimin me organizatat tjera për implementimin e dispozitave ligjore që rregullojnë pronësinë industriale;
- Përfaqësimin e Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare për pronësi industriale.

Infrastruktura ligjore me të cilën vepron Agjencia përbëhet nga Ligjet dhe Udhëzimet Administrative:

- Ligji nr. 08 L-075 për Markat Tregtare;
- Ligji nr. 08 L-076 për mbrojtjen e Sekreteve Tregtare;
- Ligji nr. 08 L-053 për Topografitë e Gjysmëpërçuesve;
- Ligji nr. 08 L-055 për Dizajnin Industrial;
- Ligji nr. 08 L-059 për Patentat;
- Ligji nr. 05 L-051 për Treguesit Gjeografik dhe për Emërtimet e Origjinës;
- Rregullore Nr. 01-2020 e punës për Komisionin e Ekspertëve për Produkteve Bujqësore dhe Artikujt Ushqimore;
- Rregullore Nr. 21/2024 Për Organizimin E Brendshëm Dhe Sistematizimin E Vendeve Të Punës Të Agjencisë Për Pronësi Industriale;

- Udhëzimi Administrativ Nr. 08-2023 për Procedurat e Regjistrimit të Markave Tregtare;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 03-2023 për Procedurat e Regjistrimit të Dizajnëve Industriale;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 02-2023 për Procedurën e Regjistrimit të Topografive;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 01-2023 për Caktimin e Taksave për Shërbimet e ofruara nga Agjencia për Pronësi Industriale;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 14-2022 për Procedurat e Regjistrimit të Patentave;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 13-2022 për Përfaqësues të Autorizuar për Pronësinë Industriale;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 10-2022 për Kompetencat, Mandatin dhe Punën e Komisioni të Ankesave kundër Vendimeve të API-së;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 05-2022 për Caktimin e Formës, Përmbajtjes dhe Përdorimin e Logos së API-së;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 09-2018 për Përcaktimin e Simboleve për Treguesit Gjeografikë, Emërtimet e Origjinës dhe Specialitetit Tradicional të Garantuar;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 11-2016 për Treguesit Gjeografikë.

Stafi i Agjencisë për Pronësi Industriale përbëhet nga 12 zyrtarë.

Agjencia e Pronësisë Industriale ka web faqen e saj www.kipa.rks-gov.net . Në këtë web faqe publikohen të gjitha aktivitetet e Agjencisë, aplikacionet për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale, Buletini Zyrtarë dhe informacionet të tjera mbi objektet e pronësisë industriale.

Hyrje

Agjencia e Pronësisë Industriale (API), në kuadër të zbatimit të Planit të Integritetit 2023–2026 dhe në përputhje me obligimet ligjore për monitorim, raportim dhe përditësim periodik të masave, parasheh që gjatë vitit 2026 të ketë rishikim dhe vlerësim të rreziqeve të integritetit.

Ky proces është zhvilluar duke u mbështetur në analizën e zhvillimeve institucionale dhe ligjore, në nevojën për të reflektuar ndryshimet që priten gjatë periudhës së ardhshme siç është forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar përmes anëtarësimeve, marrëveshjeve institucionale dhe angazhimit në projekte rajonale e globale me organizata si WIPO, EPO, EUIPO dhe CEFTA.

Në këtë kuadër, synohet nënshkrimi i marrëveshjeve me zyrat partnere, zbatimi i aktiviteteve të përbashkëta për harmonizim rajonal, përfitimi nga asistenca teknike dhe digjitalizimi i sistemit në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Përmes këtij vlerësimi janë identifikuar edhe rreziqe të reja të cilat lidhen kryesisht me rekrutimin i zyrtarëve të ri dhe avancimin e zyrtarëve aktual në fushën e ekzaminimit dhe shqyrtimit të lëndëve në përgjithësi, duke filluar nga procedura e aplikimit, publikimit, shqyrtimit deri tek marrja e vendimeve si për regjistrim, refuzim apo edhe në shqyrtimin e kundërshtimeve, si instrumente kyçe për forcimin e integritetit dhe llogaridhënies.

Masat e parashikuara në Planin e Integritetit dhe Përditësimi

Nr.	Fusha rrezikut	Masa e propozuar (nga Plani ekzistues)	Veprimet ndërmarra gjatë periudhës	Statusi i zbatimit (i përbushur / pjesërisht / jo i përbushur)	Vështirësitë e hasura	Propozimi për vitin 2026 (ruhet / ndryshohet / hiqet / masë e re)	Komente shprehëse
1	Ndikimi i jashtëm në punën e zyrtarëve dhe shërbimet e konfliktit të interesit	Digitalizimi i gjithë procesit dhe të përmirësohet sistemi i arkivimit të dokumenteve/dosjeve	Ka filluar implementimi i masës së propozuar, ku Agjencinë e ka vizituar përfaqësuesi i WIPO-s. Janë bërë testimet e para të softwarit të ri IPAS, dhe pas trajnimit të zyrtarëve të API-se me datë 25.10.2025 dhe ne koordinimi me ASHI-në do të fillojë migrimi i të dhënave të plota në versionin e ri, i cili pritet të realizohet gjatë vitit 2026	Pjesërisht	Vështirësitë teknike gjatë realizimit të programit në API dhe WIPO Mungon nënshkrimi elektronik Mungesa e stafit për implementimin e aplikimeve online	Ruhet	Ruhet sepse vazhdon digitalizimi i plotë i sistemit dhe trajnimi i zyrtarëve në këtë fushë
2	Trajtimi me vonesë i rasteve dhe procedurave si pasojë e	Zbatimi i Rregullores (ZKM) nr. 21/2024, Trajnimi i vazhdueshëm i zyrtarëve në veçanti	Janë përgatitur përkrahjet e vendeve të punës të cilat kanë derivuar nga Rregullorja për	Jo i përbushur	Zbatimi i rregullores	Ruhet	Në API është zhvilluar një procedurë rekrutimi e cila është anuluar me

	numrit të vogël të zyrtarëve	shkëmbimi i përvojave me zyrtar homologe të BE-së në fushën e pronësisë industriale.	Strukturimin e Agjencisë. Pas miratimit të tyre do të procedohet me sistematizimin e vendeve të punës.				Janë publikuar aktivitetet kryesore në web faqen https://kipa.rks-gov.net/ . Për informimin e publikut për pronësinë intelektuale, është aktive dhe web faqja në të cilën janë të përmbledhura të gjitha informatat mbi pronësinë intelektuale, https://www.pronesiaintelektuale.com/sq .	Ruhet- sepse do të behet përditësimi në versionin e ri, dhe pritet implementimi i saj	Rritja e informimit publik, kërkohet forcim i komunikimit digjital dhe publikimeve të rregullta	ankese nga KPMSHCK.
3	Forcimi i transparencës para procedurave në Agjenci	Agjencia të ofrojë qasje më të lehtë në informimin e nevojshëm duke rritur përgjegjësinë e plotë me palët e interesuara, dhe zyrtaret kanë detyrim të ushtrojë detyrat me transparencë të plotë dhe duhet të sigurojë për publikun çdo informacion të kërkuar, sipas legjislacionit përkatës për qasjen në dokumente publike	Vazhdon përditësimi i regjistrimit online për objektet e pronësisë industriale. Regjistri përditësohet çdo vit kalendarik.	Pjesërisht i përmbyshur						
4	Zbatimi i etikës dhe rregullave të disiplinës në punë	Zyrtaret e agjencisë duhet të veprojnë me profesionalizëm, paanësi, mos diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi	Në Agjencinë e Pronësisë Industriale, zbatohen rregullat e etikës dhe disiplinës në punë të menaxhuara nga stafi udhëheqës i MINT duke përfshirë verifikimin	Pjesërisht	Vështirësitë teknike gjatë zbatimit	Ruhet	Zbatimi i legjislacionit në fuqi			

5	Vetëdijësimi i opinionit për rolin dhe rëndësinë e mbrojtjes së drejtave të pronësisë industriale në fushën e Patentave dhe Dizajnit Industrial	Takime promovimi me palët e interesit për informimin dhe rolin e mbrojtjes së objekteve të pronësisë industriale, sepse numri i aplikimeve për patenta dhe dizajnit industrial mbetet i ulët	API vazhdimisht synon nxitjen e kulturës së mbrojtjes së pronësisë industriale në mesin e bizneseve vendore, përmes organizimit të fushatave informuese dhe edukative në shkolla, universitete dhe oda ekonomike, pjesëmarrjes në panairë dhe aktivitete publike, shënimin të Ditës Botërore të Pronësisë Intelktuale dhe promovimit të mbrojtjes përmes mediave digjitale	Pjesërisht	Mos implementimi i Rregullores Nr. 21/2024 Për Organizimin E Brendshëm Dhe Sistematizimin E Vendeve Të Punës Të Agjencisë Për Pronësi Industriale	Ndryshohet- afati 12 muaj	Të vazhdohet me sesione informuese në vazhdimësi sidomos në fushën e Patentave dhe Dizajneve. Sa i përket vetëdijësimi për regjistrimin e markave tregtare të dhënat mbi aplikimet e pranuar tregojnë një rritje të aplikimeve vendore .	Zbatimi i legjislacionit në fuqi dhe i Planit të Integritetit
6	Përgjegjshmëria, llogaridhënia dhe integritetit i zyrtarëve	Agjencia do të vazhdojë të kërkojë nga zyrtarët ndershmëri, përkushtim dhe llogaridhënie gjatë kryerjes së detyrave të tyre, duke zbatuar me rreptësi rregullat dhe disiplinë në punë	Raportimi javor, mujor dhe vjetor, dhe mbikëqyrja e punëve të realizuara përmes sistemit IPAS.	Pjesërisht	Vështirësitë teknike gjatë zbatimit	Ruhet		

7	Menaxhimi i të drejtave të Pronësisë Industriale me fokus të veçantë në fushën e Treguesve Gjeografik dhe Emërimit të Origjinës	Rritja e ndërgjegjësimit të prodhuesve dhe palëve të interesit mbi rëndësinë e mbrojtjes dhe përfitimet ekonomike nga mbrojtja e Treguesve Gjeografik dhe Emërimit të Origjinës	Agjencia për Pronësi Industriale ka regjistruar Emërimitin e parë të origjinës në Kosovë, “Djathin e Sharrit” dhe verëra “Rahoveci” si produkte vendore.	Pjesërisht	Pas këtyre regjistrimeve, nuk janë pranuar aplikacione të reja për tu mbrojtur sipas Ligjit për Treguesit Gjeografikë dhe Emërime të Origjinës.	Ndryshon - sepse pritet të bëhet rekrutimi i një zyrtari përgjegjës për TGJ dhe EO , si dhe funksionalizimi i divizionit të promovimit Afati- brenda vitit 2026	Njësia për promovimin e fushave për pronësi industriale të ketë synim më të madh në nxitjen e kulturës për TGJ dhe EO tek bizneseve vendore
8	Shqyrtimi i kundërshtimeve	Agjencia do të vazhdoj organizimin e trajnimeve specifike lidhur me shqyrtimin e kundërshtimeve dhe shfuqizime, dhe revokimeve	API deri me tani ka shqyrtuar një numër të madhe të kundërshtimeve ka arritur shqyrtimin e tyre deri në vitin 2024 të cilat kanë qenë të pa shqyrtuara që nga viti 2013, mirëpo aktualisht ka vetëm një zyrtar për shqyrtimin e kundërshtimeve	Pjesërisht	Numri i vogël i zyrtarëve për shqyrtimin e kundërshtimeve	Ruhet - rekrutimi i zyrtarit të lartë për shqyrtimin e kundërshtimeve, shfuqizime, dhe revokimeve ashtu siç është përcaktuar në Rregulloren Nr. 21/2024 Për Organizimin E Brendshëm Dhe Sistematizimin E Vendeve Të Punës Të Agjencisë Për Pronësi Industriale	Agjencia të organizoj trajnime specifike lidhur me shqyrtimin e kundërshtimeve ,shfuqizimeve dhe revokimeve.

Nr.	Fusha rrezikut	Masa e propozuar (nga Plani ekzistues)	Veprimet ndërmarra gjatë periudhës	Statusi i zbatimit	Vështirësitë e hasura	Propozimi për vitin 2026	Komente shtesë
9	Mungesa e avancimit të zyrtarëve dhe shpërndarja e disa përgjegjësi të tjera brenda stafit të Agjencisë	Hapja e konkurseve të reja (për mundësinë e avancimit të stafit në API)	Pas hyrjes në fuqi të Rregullores me nr. 21/2024 me datë publikimi 22.11.2024 janë përgatitur përkohërisht vendet e punës të cilat kanë derivuar nga Rregullorja në fjalë	Jo i përmbyshur	Kryesisht vështirësitë paraqiten tek zgjatja e afateve për shqyrtimin e lendeve. Duke u bazuar në përvojën e punës të zyrtarëve, hapja e konkurseve dhe shpërndarja e përgjegjësi brenda Agjencisë konsiderohet se llogaridhënia do të ishte më në nivel se aktualisht	Implementimi i rregullores Rregullore me nr. 21/2024. Afati i parapare 12 muaj	API ka në fokus zhvillimin dhe avancimin e kapaciteteve profesionale të stafit, përmes rekrutimit të zyrtarëve të rinj dhe organizimit të trajnimeve të specializuara në fushën e patentave, markave dhe dizajneve industriale.
10	Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar	Synohet nënshkrimi i marrëveshjeve me zyrtarë partnere, zbatimi i aktiviteteve të përbashkëta për harmonizim rajonal, përfitim i asistencës teknike dhe digitalizimi i sistemit në përputhje me standardet ndërkombëtare	Deri me tani API ka dërguar dy shkresa zyrtare tek Zyra e Evropiane e Patentave por nuk ka marrë përgjigje. Po ashtu API ka mbajtur disa takime me përfaqësuesit e EUIPO ku janë pajtuar për nënshkrimin e një marrëveshje teknike për bashkëpunim në	Jo i përmbyshur	Vështirësitë janë të natyrës politike pasi që Kosova nuk është pjesë e UN	Vazhdimi i kontakteve për të forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar, njëra prej tyre është avancimi i sistemit elektronik përmes WIPO-s i mbështetur nga UNDP. Afati i parapare 12 muaj	Është shumë me rëndësi të planifikohen veprime institucionale për të mundësuar aplikimin e bizneseve vendore për marka evropiane, sepse mungon country code në

			mes te dy zyrave, mirëpo API nuk ka pranuar draft marrëveshjen apo përgjigje përfundimtare nga ana e tyre. API ka mbajtur disa takime me përfaqësuesit e MPJ-së përgjegjës për Organizata Ndërkombëtare, ku kanë shikuar mundësinë e aplikimit të Republikës së Kosovës në WIPO, ku janë pajtuar që të zhvillohet kontakti me WIPO përmes Konsullit të Kosovës në Gjeneve, këto kontakte të para do ti adresojnë kushtet e Kosovës drejt anëtarësimit në WIPO.				regjistrat ndërkombëtar, që pamundëson aplikimin e tyre.
--	--	--	--	--	--	--	---

Agjencisë për Pronësi Industriale duke u bazuar në neni 25 të Ligjit Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit bënë Përditësimin e Planit të Integritetit, në rastet si më poshtë:

3.1.Kur masat janë realizuar me sukses dhe lind nevoja për vendosjen e prioriteteve të reja;

API duke u bazuar në takimet e grupit punues të mbajtur me dt.17.11.2025 , 12.12.2025-14.12.2025 në bazë të vendimit me nr.prot.205/2023 me datë 04.10.2023 për hartimin e Planit të Integritetit ka shqyrtoi kornizën ligjore (Ligjet, Rregulloret dhe UA, si dhe burime të tjera të informacioni për fushat dhe proceset e punës dhe në bazë të nenit 25 të Ligjit Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ka vendosur të bëhet Përditësimi i Planit të Integritetit duke vlerësuar se ka lindur nevoja për vendosjen/ ndryshimin e prioriteteve të reja në fushat e rrezikut në pikat 5 dhe 7 dhe konsideron se këto dy masa janë duke u realizuar me sukses dhe vendoset të ndryshohen dhe të jenë me specifike.

Tek fusha e rrezikut pika 5 “Vetëdijesimi i opinionit për rolin dhe rëndësie e mbrojtjes së drejtave të Pronësisë Industriale”, komisioni konstatoi se vetëdijesimi i opinionit për rolin dhe rëndësie e mbrojtjes së drejtave të Pronësisë Industriale të jetë më në fokus në fushën e **Patentave dhe Dizajnit Industrial**, të ketë takime promovimi me palët në interes për informimin dhe rolin e mbrojtjes së objekteve në fjalë, sepse numri i aplikimeve për patenta dhe dizajne industriale mbetet i ulët kurse sa i përket aplikimit për marka tregtare numri i aplikimeve është në rritje. Dhe këtu qëndron arsyetimi i ndryshimit të kësaj fushe.

Tek fusha e rrezikut pika 7 “Menaxhimi i të drejtave të Pronësisë Industriale”, komisioni konstatoi se duhet të ndryshohet sepse menaxhimi i të drejtave të Pronësisë Industriale sidomos në fushën e **Emërtimit të Origjinës** duhet të ketë një rendësi të veçantë për vendin tonë sepse garantohet autenticitetin.

Emërtimi i origjinës siguron që produktet janë prodhuar, përpunuar dhe përgatitur në zonën e caktuar, duke garantuar se konsumatori merr një produkt autentik dhe jo një imitim.

Emërtimi i origjinës, vlerëson dhe ruan faktorët natyrorë dhe traditat e trashëguara të prodhimit, duke mbrojtur identitetin kulturor dhe historik të komuniteteve vendore.

Rendësi të veçantë ka edhe cilësia e produktit e cila lidhet ngushtë me mjedisin natyror dhe traditat njerëzore të zonës. Emërtimi i origjinës mbron këto cilësi unike, të cilat nuk mund të riprodhohen jashtë zonës gjeografike.

Grupi punues, për këtë fushë vlerëson se duhet të mbahen sesione, takime promovimi sidomos me **NVM**, për informimin dhe rolin e mbrojtjes së emërtimit të origjinës . Me miratimin e tre udhëzuesve për ekzaminimin e objekteve të Pronësisë Industriale është bërë një hap i rëndësishëm drejt standardizimit dhe përmirësimit të procedurave brenda Agjencisë për Pronësi Industriale. Këto dokumente ofrojnë dukshëm qartësi dhe udhëzime specifike duke siguruar një proces më të qëndrueshëm dhe të drejtë për të gjithë aplikuesit. Mirëpo deri me tani Agjencia për Pronësi Industriale ka regjistruar Emërtimin e parë të origjinës në Kosovë, “Djathin e Sharrit” dhe verëra ‘Rahoveci” si produkte vendore. Pas këtyre regjistrimeve, nuk janë pranuar aplikacione të reja për tu mbrojtur sipas Ligjit për Treguesit Gjeografikë dhe Emërtime të Origjinës.

3.2.Rreziqe të reja të identifikuara

1. Mungesës së avancimit në punë:

Grupi punues në takimin e parë me datë 17.11.2025 vendosi të përcjell njoftimin për Përditësimin e Planit të Integritetit dhe një pyetësor përmes emailit tek zyrtaret e API-së.

Mbi bazën e rezultatit të pyetësorit shumica e zyrtarëve kanë propozuar identifikimin e së paku dy rreziqeve të reja ku kryesisht është **paraqitur shqetësimi i mungesës së avancimit në punë brenda Agjencisë duke u bazuar në përvojën e punës së tyre si dhe rekrutimi i zyrtarëve të ri në Agjenci e sidomos në fushën e ekzaminimit të lëndëve.**

Me hapjen e konkurseve dhe shpërndarjen e përgjegjësiave brenda Agjencisë do të ishte më në nivel llogaridhënia, rritja e performancës së stafit, përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve të regjistrimit me qëllim uljen e kohës së shqyrtimit të aplikimeve dhe trajtimin e rritjes së numrit të objekteve të pronësisë industriale të pranuar, nxjerrja e vendimeve dhe dokumenteve përfundimtare, publikimi i rregullt i Buletinit Zyrtar, projektimi dhe implementimi i platformës elektronike për aplikime, si dhe avancimi i bazës së të dhënave për kërkim dhe verifikim publik.

Pse konsiderohet i rëndësishëm:

Rreziku është i rëndësishëm sepse lidhet drejtpërdrejt me kapacitetet profesionale të institucionit, kualitetin e shërbimeve dhe respektimin e standardeve ndërkombëtare si dhe me ruajtjen e integritetit, transparencës dhe performancës së përgjithshme të Agjencisë për Pronësi Industriale. Identifikimi dhe trajtimi i tij është thelbësor për përmirësimin e funksionimit institucional dhe për përmbushjen e objektivave tjera strategjike.

Kapacitetet e pamjaftueshme të stafit sjellin vonesa në shqyrtimin e aplikimeve, nxjerrjen e vendimeve, publikimin e Buletinit Zyrtar, përpunimin dhe kontrollin e të dhënave, dhe si rrjedhojë e kësaj vije deri tek pakënaqësia e palëve të interesit.

Mungesa e stafit të trajnuar dhe e avancimeve strukturore vështirëson, implementimin e platformave elektronike, përmirësimin e bazave të të dhënave, harmonizimin e proceseve me standardet e EUIPO dhe WIPO.

Masa e propozuar parandaluese:

Avancimin e kapaciteteve profesionale të stafit përmes rekrutimit të zyrtarëve të rinj funksionalizimi i divizioneve, organizimi i trajnimeve të specializuara në fushën e patentave, markave dhe dizajneve industriale dhe përforsimi i njohurive teknike dhe juridike synon rritjen e cilësisë së vendimmarrjes, uljen e afateve të procedimit dhe harmonizimin me praktikën e EUIPO dhe WIPO.

Njësia përgjegjëse: API, MINT dhe MPB – DMZP

2. Forcimi i Bashkëpunimit ndërkombëtar:

Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar përmes anëtarësimeve, marrëveshjeve institucionale dhe angazhimit në projekte rajonale e globale me organizata si WIPO, EUIPO dhe CEFTA.

Pse konsiderohet i rëndësishëm:

Në këtë fushë, duhet të synohet nënshkrimi i marrëveshjeve me zyrat partnere, zbatimi i aktiviteteve të përbashkëta për harmonizim rajonal, përfitimi nga asistenca teknike dhe digjitalizimi i sistemit në përputhje me standardet ndërkombëtare. API është e obliguar që në bazë të nenit 78 të Ligjit nr.08/L-059 Për Patenta të nënshkruaj marrëveshje për ekzaminim e patentave të cilat kanë statusin e autoritetit të shqyrtimit paraprak ndërkombëtar për aplikimet ndërkombëtare të patentave, autoritete të cilat janë të licencuara nga WIPO.

Është shumë me rëndësi projektimi i **Planit të Implementimit** për platformën elektronike të aplikimeve të Pronësisë Industriale. Gjithashtu kjo fushë e rrezikut është e rëndësishme pasi që bizneseve vendore ju pamundësohet aplikimi në zonën e BE për objektet e pronësisë industriale në mungesë të country code.

Masa e propozuar parandaluese:

Deri me tani Agjencia për Pronësi ka tentuar të bëjë marrëveshje të bashkëpunimit me zyrat të cilat janë autoritet i patentave, por nuk ka pasur sukses. Këtë viti të synohet një punë me e madhe në këtë drejtim.

Është shumë me rëndësi të planifikohen veprime institucionale për të mundësuar aplikimin e bizneseve vendore për marka evropiane, mirëpo aktualisht vështirësitë janë të natyrës politike .

4. Rekomandimet të përgjithshme nga Agjencia

- Të vijohet me zbatimin e parashikimeve në përditësimin planit të integritetit.
- Zbatimi i Rregullores (ZKM) nr. 21/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Agjencisë për Pronësi Industriale
- Rekrutimi i stafit të ri
- Implementimi i aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve në mënyrë të vazhdueshme në procedurat për shqyrtimin e kundërshtimeve, shfuqizimeve dhe revokimeve e sidomos në fushën e ekzaminimit ku lidhet ngushtë dhe me formimin e sektorit juridik.
- Gjithashtu, reformat në teknologjinë informative ku varen nga mbështetja e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO), e cila është ofruesja dhe mirëmbajtësja e sistemit IPAS, andaj dinamika e zbatimit të këtij komponenti do të përcaktohet në koordinim me këtë organizatë.
- Të synohet nënshkrimi i marrëveshjeve me zyrat partnere, zbatimi i aktiviteteve të përbashkëta për harmonizim rajonal, përfitimi nga asistenca teknike dhe digjitalizimi i sistemit në përputhje me standardet ndërkombëtare.
- Gjithashtu, planifikohen veprime institucionale për adresimin e mungesës së country code të Kosovës në sistemin e EUIPO, për të mundësuar aplikimin e bizneseve vendore për marka evropiane.

FUSHAT E PËRGJITHSHME TË RREZIKUT									
Identifikimi i rrezikut			Intensiteti i rrezikut			Masat ndaj rrezikut			
Nr.	Fusha e rrezikut	Përshkrimi Rrezikut	Masat ekzistuese Të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin e eliminimin e rreziqeve	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati Realizimit
1	Ndikimi i jashtëm në punën e zyrtarëve dhe shmangia e konfliktit të interesit	Vështirësitë teknike gjatë realizimit të programit në API dhe WIPO. Mungon nënshkrimi elektronik Mungesa e stafit për implementimin e aplikimeve online	Po punohet për digjitalizimi i gjithë procesit dhe përmirësimin e sistemit të arkivimit të dokumenteve/dosjeve	5	10	50	Ka filluar implementimi i masës së propozuar, ku Agjencinë e ka vizituar përfaqësuesi i WIPO-s. Janë bërë testimet e para të softwarit të ri IPAS , dhe pas trajnimit të zyrtareve të API-se me datë 25.10.2025 dhe ne koordinimi me ASHI-në do të fillojë migrimi i te dhënave të plota në versionin e ri, i cili pritet të realizohet gjatë vitit 2026	API	12 muaj
2	Trajtimi me vonesë të rasteve dhe procedurave si pasojë e numrit të vogël të zyrtarëve	Në API është zhvilluar vetëm një procedurë rekrutimi e cila është anuluar me ankese nga KPMSHCK	Rregullorja (ZKM) nr. 21/2024 , Trajnimi i vazhdueshëm i zyrtarëve në veçanti shkëmbimi i përvojave me zyrtarë homologe të BE-së në fushën e pronësisë industriale.	5	8	40	Janë përgatitur përshkrimet e vendeve të punës të cilat kanë derivuar nga Rregullorja për Strukturimin e Agjencisë. Pas miratimit të tyre do të procedohet me sistematizimin e vendeve të punës	MINT/API	6 muaj

3	Forcimi i transparencës para procedurave në API	Të bëhet rritja e informimit publik, përditësimi i kërkohej forcim i komunikimit digital dhe publikimeve të rregullta	Vazhdon përditësimi i regjistrit online për objektet e pronësisë industriale. Regjistri përditësohet çdo vit kalendarik	3	9	27	Agjencia të ofroje qasje më të lehtë në informimin e nevojshëm duke rritur përgjegjësinë e plotë me palët e interesuara, dhe zyrtaret kanë detyrim të ushtrorjës detyrat me transparencë të plotë dhe duhet të sigurojë për publikun çdo informacion të kërkuar, sipas legjislacionit përkatës për qasjen në dokumente publike	API	6 muaj
4	Zbatimi i etikës dhe rregullave të disiplinës në punë	Vështirësitë teknike gjatë zbatimit. Të zbatohet legjislacioni në fuqi	Në Agjencinë e Pronësisë Industriale, zbatohen rregullat e etikës dhe disiplinës në punë të menaxhuara nga stafi udhëheqës i MINT duke përfshirë verifikimin digital në hyrje-dalje të zyrtareve.	4	10	40	Zyrtaret e agjencisë duhet të veprojnë me profesionalizëm, paanësi, mosdiskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi	MINT dhe API	6 muaj

5	Vetëdijësimi i opinionit për rolin dhe rëndësinë e mbrojtjes së drejtave të pronësisë industriale në fushën e Patentave dhe Dizajnit Industrial	Mos implementimi i Rregullores Nr. 21/2024 Për Organizimin E Brendshëm Dhe Sistematizimin E Vendeve Të Punës Të Agjencisë Për Pronësi Industriale	Takime promovimi me palët e interesit për informimin dhe rolin e mbrojtjes së objekteve të pronësisë industriale, sepse numri i aplikimeve për patenta dhe dizajnit industrial mbetet i ulët	4	10	40	API vazhdimisht synon nxitjen e kulturës së mbrojtjes së pronësisë industriale në mesin e bizneseve vendore, përmes organizimit të fushatave informuese dhe edukative në shkolla, universitete dhe oda ekonomike, pjesëmarrjes në panairë dhe aktivitete publike, shënimin të Ditës Botërore të Pronësisë Intelektuale dhe promovimit të mbrojtjes përmes mediave digjitale	API	12 muaj
6	Përgjegjshmëria, llogaridhënia dhe integriteti i zyrtarëve	Vështirësitë teknike gjatë legjisacionit në fuqi dhe i Planit të realizuara përmes Integritetit	Raportimi i javor, mujor dhe vjetor, dhe mbikëqyrja e punëve të sistemit IPAS.	3	7	21	Agjencia do të vazhdojë të kërkojë nga zyrtarët ndershmëri, përkushtim dhe llogaridhënie gjatë kryerjes së detyrave të tyre, duke zbatuar me rreptësi rregullat dhe disiplinën në punë	MINT dhe U.D. Drejtori i Përgjithshëm	6 muaj

7. Menaxhimi i të drejtave të Pronësisë Industriale me fokus të veçantë në fushën e Treguesve Gjeografik dhe Emërimit të Originës	Janë lëshuar vetëm dy vendime dhe nuk janë pranuar aplikacione të reja për tu mbrojtur sipas Ligjit për Treguesit Gjeografikë dhe Emërime të Originës.	Agjencia për Pronësi Industriale ka regjistruar Emërimin e parë të originës në Kosovë, "Djathin e Sharrit" dhe verëra "Rahoveci" si produkte vendore	4	10	40	Rritja e ndërgjegjësimit të prodhuesve dhe palëve të interesit mbi rëndësinë e mbrojtjes dhe përfitimet ekonomike nga mbrojtja e Treguesve Gjeografik dhe Emërimit të Originës	API	6 muaj
8. Shqyrtimi i kundërshtimeve	Numri i vogël i zyrtarëve për shqyrtimin e kundërshtimeve	API deri me tani ka shqyrtuar një numër të konsiderueshëm të kundërshtimeve ka arritur shqyrtimin e tyre deri ne vitin 2024 të cilat kanë qenë të pa shqyrtuara që nga viti 2013, mirëpo aktualisht ka vetëm një zyrtar për shqyrtimin e kundërshtimeve	3	7	21	Agjencia do të vazhdoj organizimin e trajnimeve specifike lidhur me shqyrtimin e kundërshtimeve, shfuqizime, dhe revokimeve	API	12 muaj

9.Mungesa e avancimit të zyrtarëve dhe shpërndarja e disa përgjigjeve të tjera brenda stafit të Agjencisë	Kryesisht vështirësitë paraqiten tek zgjatja e afateve për shqyrtimin e lendeve. Duke u bazuar në përvojën e punës të zyrtarëve, hapja e konkurseve dhe shpërndarja e përgjigjeve brenda Agjencisë konsiderohet se llogaridhënia do të ishte më në nivel se aktualisht	Pas hyrjes në fuqi të Rregullores me nr. 21/2024 me datë publikimi 22.11.2024 janë përgatitur përkshkrimet e vendeve të punës të cilat kanë derivuar nga Rregullorja në fjalë.	4	10	40	Hapja e konkurseve të reja (për mundësinë e avancimit të stafit në API) API ka në fokus zhvillimin dhe avancimin e kapaciteteve profesionale të stafit, përmes rekrutimit të zyrtarëve të rinj dhe organizimit të trajnimeve të specializuara në fushën e patentave, markave dhe dizajneve industriale.	API	Afati 6 muaj
10.Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar	Vështirësitë janë të natyrës politike pasi që Kosova nuk është pjesë e UN	Deri me tani API ka dërguar dy shkresa zyrtare tek Zyra e Evropiane e Patentave por nuk ka marrë përgjigje. Po ashtu API ka mbajtur disa takime me përfaqësuesit e EUIPO ku janë pajtuar për nënshkrimin e një marrëveshje teknike për bashkëpunim në mes të dy zyrave, mirëpo API nuk ka pranuar draft marrëveshjen apo përgjigje përfundimtare nga ana e tyre. API ka mbajtur disa takime me përfaqësuesit e MPJ-së	4	10	40	Synohet nënshkrimi i marrëveshjeve me zyrat partnere, zbatimi i aktiviteteve të përbashkëta për harmonizim rajonal, përfitim nga asistenca teknike dhe digjitalizimi i sistemit në përputhje me standardet ndërkombëtare. Vazhdimi i kontakteve për të forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar, njëra prej tyre është avancimi i sistemit elektronik përmes WIPO-s i mbështetur nga UNDP. Është shumë me rëndësi të planifikohen veprime institucionale për të mundësuar aplikimin e bizneseve vendore për marka evropiane, sepse mungon country code në regjistrat ndërkombëtar, që pamundëson aplikimin e tyre.	API	12 muaj

						përgjegjës për Organizata Ndërkombëtare, ku kanë shikuar mundësinë e aplikimit të Republikës së Kosovës në WIPO, ku janë pajtuar që të zhvillohet kontakti me WIPO përmes Konsullit të Kosovës në Gjeneve, këto kontakte të para do ti adresojnë kushtet e Kosovës drejt anëtarësimit në WIPO.	
--	--	--	--	--	--	--	--